

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Shukri Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtar, në çështjen juridike të paditësit A. F., nga Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson H. I., avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Banka Qendrore e Kosovës me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar S. K., për pagimin e të ardhurave personale, përkitazi me revizionin e paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.41/2013 datë 16.9.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13.10.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.41/2013 datë 16.9.2015.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.41/2013 datë 16.9.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Komonale në Ferizaj C.nr.342/2008 datë 22.10.2012, me të cilin aktgjykim është refuzuar kërkesëpadia e paditësit si e pabazuar që të detyrohet e paditura paditësit t'ia paguajë në emër të shpërblimit të dëmit për shkak të pamundësisë së realizimit të pagave mujore për periudhën prej 01.9.1990 deri më 7 mars 1999, shumën prej 21.018 €, (njëzetë e njëmijë e tetëmbëdhjetë €), me kamatë vonesë vjetore prej 3.5%, në shumat mujore deri në ditën e pagesës në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi , nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë dhe atë:

1. Për shtator 1990 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.10.1990,
2. Për tetor 1990 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.11.1990,
3. Për nëntor 1990 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.12.1990,
4. Për dhjetor 1990 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.01.1991,
5. Për janar 1991 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.02.1991,
6. Për shkurt 1991 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.03.1991,
7. Për mars 1991 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.04.1991,
8. Për prill 1991 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.05.1991,
9. Për maj 1991 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.06.1991,
10. Për qershor 1991 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.07.1991,
11. Për korrik 1991 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.08.1991,
12. Për gusht 1991 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.09.1991,
13. Për shtator 1991 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.10.1991,
14. Për tetor 1991 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.11.1991,
15. Për nëntor 1991 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.12.1991,
16. Për dhjetor 1991 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.01.1992,
17. Për janar 1992 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.02.1992,
18. Për shkurt 1992 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.03.1992,
19. Për mars 1992 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.04.1992,
20. Për prill 1992 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.05.1992,
21. Për maj 1992 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.06.1992,
22. Për qershor 1992 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.07.1992,
23. Për korrik 1992 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.08.1992,
24. Për gusht 1992 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.09.1992,
25. Për shtator 1992 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.10.1992,
26. Për tetor 1992 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.11.1992,
27. Për nëntor 1992 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.12.1992,
28. Për dhjetor 1992 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.01.1993,
29. Për janar 1993 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.02.1993,
30. Për shkurt 1993 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.03.1993,
31. Për mars 1993 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.04.1993,
32. Për prill 1993 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.05.1993,
33. Për maj 1993 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.06.1993,

34. Për qershor 1993 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.07.1993,
35. Për korrik 1993 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.08.1993,
36. Për gusht 1993 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.09.1993,
37. Për shtator 1993 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.10.1993,
38. Për tetor 1993 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.11.1993,
39. Për nëntor 1993 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.12.1993,
40. Për dhjetor 1993 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.01.1994,
41. Për janar 1994 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.02.1994,
42. Për shkurt 1994 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.03.1994,
43. Për mars 1994 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.04.1994,
44. Për prill 1994 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.05.1994,
45. Për maj 1994 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.06.1994,
46. Për qershor 1994 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.07.1994,
47. Për korrik 1994 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.08.1994,
48. Për gusht 1994 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.9.1994,
49. Për shtator 1994 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.10.1994,
50. Për tetor 1994 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.11.1994,
51. Për nëntor 1994 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.12.1994,
52. Për dhjetor 1994 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.1.1995,
53. Për janar 1995 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.2.1995,
54. Për shkurt 1995 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.3.1995,
55. Për mars 1995 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.4.1995,
56. Për prill 1995 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.5.1995,
57. Për maj 1995 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.6.1995,
58. Për qershor 1995 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.7.1995,
59. Për korrik 1995 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.8.1995,
60. Për gusht 1995 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.9.1995,
61. Për shtator 1995 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.10.1995,
62. Për tetor 1995 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.11.1995,
63. Për nëntor 1995 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.12.1995,
64. Për dhjetor 1995 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.1.1996,
65. Për janar 1996 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.2.1996,
66. Për shkurt 1996 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.3.1996,

67. Për mars 1996 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.4.1996,
68. Për prill 1996 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.5.1996,
69. Për maj 1996 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.6.1996,
70. Për qershor 1996 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.7.1996,
71. Për korrik 1996 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.8.1996,
72. Për gusht 1996 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.9.1996,
73. Për shtator 1996 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.10.1996,
74. Për tetor 1996 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.11.1996,
75. Për nëntor 1996 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.12.1996,
76. Për dhjetor 1996 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.1.1997,
77. Për janar 1997 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.2.1997,
78. Për shkurt 1997 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.3.1997,
79. Për mars 1997 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.4.1997,
80. Për prill 1997 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.5.1997,
81. Për maj 1997 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.6.1997,
82. Për qershor 1997 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.7.1997,
83. Për korrik 1997 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.8.1997,
84. Për gusht 1997 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.9.1997,
85. Për shtator 1997 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.10.1997,
86. Për tetor 1997 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.11.1997,
87. Për nëntor 1997 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.12.1997,
88. Për dhjetor 1997 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.1.1998,
89. Për janar 1998 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.2.1998,
90. Për shkurt 1998 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.3.1998,
91. Për mars 1998 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.4.1998,
92. Për prill 1998 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.5.1998,
93. Për maj 1998 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.6.1998,
94. Për qershor 1998 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.7.1998,
95. Për korrik 1998 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.8.1998,
96. Për gusht 1998 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.9.1998,
97. Për shtator 1998 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.10.1998,
98. Për tetor 1998 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.11.1998,
99. Për nëntor 1998 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.12.1998,

100. Për dhjetor 1998 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.1.1999,
101. Për janar 1999 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.2.1999,
102. Për shkurt 1998 shumën prej 206 €, me kamatë prej 03.3.1999,

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi ka paraqitur revizion, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar, ndërsa ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të kundërshtuar sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se me vendimit e Bankës Popullore të Jugosllavisë-Entit për Llogaritje dhe Pagesa-Filiala në Ferizaj, nr..., datë ..., paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Ferizaj CI.nr.1080/1992 datë 26.6.1998, janë prishë aktvendimi nr..., datë ..., për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe vendimi mbi refuzimin e kundërshtimit nr..., datë ..., ndërsa është obliguar e paditura që paditësin ta kthejë në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës. Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, Prishtinë, CA.nr.597/98 datë 14.9.1998, është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Me propozimin e datës 18 janar 1998, paraqitur para gjykatës IV në Beograd, paditësi ka propozuar përmbarimin e aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale, Ferizaj, CI.nr.1080/92, ndërsa e njëjta gjykatë me aktvendimin E.nr.VIII-600/98 datë 20.11.1998, ka caktuar përmbarimin e propozuar. Më datë 19.3.1999, paditësi i është drejtuar Bankës Popullore të Jugosllavisë-Entit për llogaritje dhe pagesa-Filiala në Ferizaj, për kompensimin-pagimin e të ardhurave personale për periudhën nga data 6.9.1990, deri më 1.3.1999, për të cilën kërkesë nuk është vendosur.

Me datë 19.4.2000, paditësi ka paraqitur padi kundër të paditurës për kompensimin e të ardhurave personale.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave, me aktgjykimin C.nr.10/2000 datë 7.4.2003, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, të cilin aktgjykim Gjykata e Qarkut në Prishtinë e ka prishë me aktvendimin CA.nr.446/2003 datë 24.5.2005, ndërsa çështjen ia ka kthyer gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Më datë 4.12.2006, paditësi ka precizuar kërkesëpadinë, ndërsa me aktgjykimin C.nr.312/2005 datë 1.12.2006, gjykata e shkallës së parë ka refuzuar kërkesëpadinë si të pabazuar, ndërsa gjykata e shkallës së dytë duke vendosur sipas ankesës me aktvendimin CA.nr.499/2007 datë 07.10.2008, ka prish aktgjykimin e ankimuar, ndërsa çështjen ia ka kthyer gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Me parashtrësat e datës 24.1.2011 dhe 1.10.2012, paditësi ka precizuar kërkesëpadinë, ndërsa Gjykata Komunale në Ferizaj me aktgjykimin C.nr.342/08 datë 22.10.2012, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit me arsyetim se e paditura nuk e ka legjitimitetin e palës në procedurë, për faktin se për periudhën për të cilën kërkohen të ardhurat personale, Banka Qendrore e Kosovës nuk ka ekzistuar dhe nuk është pasardhëse e ish Kontabilitetit Shoqëror apo të ish Bankës Popullore të Jugosllavisë.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore i ka pranuar në tërësi konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, pastaj ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimit.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatat e instancës më të ulët , në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, drejt kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit për pagesën e të ardhurave personale për periudhën kohore të lartpërmendur , është e pabazuar.

Thëniet e revizionit se dy gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të gabuar kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se e paditura nuk ka legjitimacion pasiv, Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi si të pabazuar, kjo nga se , Përfaqësuesi Special i Sekretariatit të Përgjithshëm ,në bazë të autorizimeve që i janë dhënë , me qëllim të forcimit të ekonomisë në Kosovë, për të ofruar një sistem efikas pagesash dhe një sistem bankar të shëndoshë, me Rregulloren nr.1999/20 datë 15.11.1999, ka themeluar autoritetin bankar dhe të pagesave në Kosovë. Sipas nenit 1 të Rregullosës së cekur Autoriteti Bankar dhe i Pagesave në Kosovë, është një person juridik publik i veçantë, ndërsa me qëllim të ricaktimit të autoritetit bankar dhe të pagesave në Kosovë, si autoritet qendror bankar i Kosovës dhe shtimit të autorizimit të tij lidhur me mbikëqyrjen, rregullimin dhe licencimin e institucioneve financiare në Kosovë, me nenin 1 të Rregullosës nr.2006/47 datë 24.08.2006, mbi Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës është përcaktuar që Autoriteti Bankar i Kosovës (AQBK), është pasardhëse e autoritetit bankar dhe të pagesave të Kosovës, si subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota si person juridik sipas

Ligjit në fuqi në Kosovë, kurse as me këtë rregullore nuk është paraparë se AQBK, është pasardhës-trashëgimtar juridik i Bankës Popullore të Jugosllavisë-Entit për Llogaritje dhe Pagesa-Filiala në Ferizaj, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykatat e instancës më të ulët në mënyrë të drejtë kanë zbatuar dispozitat ligjore kur kanë gjetur se e paditura nuk e ka legjitimitetin pasiv në këtë çështje juridike dhe kur kanë refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Pretendimi i cekur në revizion se e paditura i shfrytëzon jo vetëm patundshmëritë e ish SHKSH të Kosovës, por edhe mjetet tjera , e nga ky fakt ekziston përgjegjësia e të paditurës për përmbushjen e detyrimit ndaj paditësit, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, nga se me nenin 1 të Rregullores nr.1999/11 datë 13.10.1999, është përcaktuar që të gjitha pajisjet dhe objektet, duke përfshirë këtu gjithë pasurinë e tundshme dhe të patundshme, që gjinden në Kosovë dhe janë përdorur nga Shërbimi i Pagesave Publike në Kosovë, me seli në Prishtinë, do të përdoren dhe administrohen nga UNMIK-u. E paditura me asnjë rregullore apo ligj nuk ka marrë ndonjë detyrim nga marrëdhënia e punës për punëtorët e Bankës Popullore të Jugosllavisë-Entit për Llogaritje dhe Pagesa-Filiala në Ferizaj, e cila është obliguar që paditësin ta kthejë në punë dhe t'ia njohë të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, andaj pretendimet e cekura në revizion se gjykatat e instancës më të ulët të drejtën materiale e kanë zbatuar në mënyrë të gabuar, koj Gjykatë e vlerësoi si të pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi edhe pretendimin e revizionit se është normale që bashkë me pronën të kanë kaluar edhe detyrimet , se paditësi sipas aktgjykimit të cekur ka punuar deri më 8 maj 2002, në të njëjtën ndërtesë të ish Shërbimit të Kontabilitetit Shoqëror të Kosovës-Filiala në Ferizaj, por të njëjtat nuk ndikuan që kjo gjykatë të merr vendim ndryshe, nga arsyet të cilat janë dhënë më lartë në këtë aktgjykim.

Nga sa u tha më lart e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.250/2016 datë 13.10.2016

Kryetare e kolegjit,
Emine Kaçiku